

PROGRAMI I PARTIA TURKE E DREJTËSISË SË KOSOVËS

Programi i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , i cili synon jetësimin, avancimin dhe zgjerimin e të drejtave të barabarta kushtetuese të turqve të Kosovës, shpjegon strukturën e Partisë dhe përmban parimet e veprimtarisë politike.

Zotohet për sigurimin e përdorimit të barabartë dhe të zyrtarizimit të gjuhës turke; për lirinë e arsimit, për kulturën, për artin, për letërsinë dhe për veprimtarinë mediale.

Angazhohet për mbrojtjen dhe për zhvillimin e besimit, të kulturës, të traditës dhe të zakoneve të komunitetit turk dhe të anëtarëve të partisë.

Zotohet edhe për mundësinë e bashkëpunimit me subjekte politike, të cilat i kushtojnë rëndësi politikës së komunitetit turk, stilit të jetës, tolerancës, dashurisë, drejtësisë dhe vlerave turke në përgjithësi. Vullnetin kombëtar, në parim, e konsideron fuqi determinuese.

Partia jonë do të angazhohet për lumturi dhe për paqe njerëzore, për siguri, për drejtësi, për shëndet dhe për të gjitha vlerat e jetës së njeriut, pasi angazhimin për njeriun e konsideron si shërbimin më madhor.

Synim kryesor i Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të jetë: ruajtja e vlerave nga e kaluara dhe ngritja e tyre në nivelin e qytetërimeve bashkëkohore; rindërtimi i Kosovës; zhvillimi i gjithanshëm i Kosovës; ruajtja e identitetit të turqve në një Kosovë shumetnike, shumëfetare e shumëkulturore; jetësimi dhe promovimi i traditave dhe i zakoneve tona. Arteria kryesore e partisë sonë do të jetë respektimi i etikës dhe i vlerave njerzore.

Partia jonë, në veçanti, çmon krijimin e familjes, pasi e konsideron familjen bazë të shoqërisë turke dhe urë lidhëse ndërmjet të kaluarës dhe të ardhmes.

I jep përparësi punësimit, ndarjes së drejtë të punëve dhe investimit në ardhmëri; prandaj njeriun e konsideron bazë dhe synim të zhvillimit ekonomik. Me kuadrot ekzistuese do të mundësojë investime të reja në prodhimtari dhe

do të ndërmarrë iniciativa të shpejta për krijimin e vendeve të reja të punës, në mënyrë që të rinjve tanë t'u krijohen fusha të reja të punësimit. I çmon tiparet pluraliste, pjesëmarrëse, konkurruese të demokracisë përfaqësuese dhe mbron idenë e themelimit dhe të jetësimit të një administrate publike të mbikëqyrur, në mënyrë që të jetësohen tiparet në fjalë.

Mbron idenë se bindjet dhe mendimet duhet të promovohen në përputhje me ligjin dhe se të drejtat dhe liritë themelore nuk mund të jenë objekt votimi.

Angazhohet për realizimin e të drejtës për gjykim të drejtë dhe për liri të kërkimit të drejtësisë, në mënyrë që të eliminohen pengesat parandaluese të mbizotërimit të të drejtëve.

Pasi e konsideron institucionalizimin si njërin prej synimeve të saj, partia jonë do të krijojë mundësi që të zhvillohen politika afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të përshtatshme për të gjitha vendbanimet, në mënyrë që qytetarët produktivë të jetojnë në mirëqenie. Në këtë kontekst, do të zhvillohen projekte për nevoja të caktuara, në mënyrë që të përmbushen kërkesat në bazë të planeve rajonale nga fushat e shëndetësisë, e ekonomisë, e arsimit dhe e bujqësisë. Me institucionalizimin si tipar i domosdoshëm në Kosovë, do të krijohet qasja te qytetarët, ashtu që do të dëgjohen problemet e popullit dhe do të gjenden zgjidhje për ato probleme dhe, në atë mënyrë, do të dëshmohet besueshmëria.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës është e vetëdijshme për përgjegjësinë ndaj turqve që jetojnë në Kosovë, pasi është e ditur se komuniteti turk me shekuj ka kontribuar për zhvillimin e gjithanshëm të vendit tonë dhe pasi dihet angazhimi i komunitetit për ekzistencën e vendit tonë.

Punon për trajtimin e problemeve në nivel lokal dhe qendror. Angazhohet për aktivitete jashtë vendit dhe për themelimin e zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare .

Me zgjedhjen e këtyre çështjeve, populli ynë do të fitojë vetëbesim dhe do t'i mundësohet atij të shikojë drejt ardhmërisë më me shpresë.

Ofron hapësirë për zbatimin dhe për zhvillimin e veprimtarive gjithëpërfshirëse, të cilat janë miratuar në Kuvendin e parë të Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës .

PARATHËNIE

Pasi njeriu është faktor i ndryshimit dhe pasi nuk ka kërkesa të reja në politikën turke, Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës themelohet nga ndërmarrësit turq me qëllim të hapjes së horizonteve të reja në jetën politike për njerëzit tanë të pashpresë, me qëllim të zhvillimit të jetesës dhe të sigurimit të një fushe më të sigurt jetësore dhe për t'i kontribuar përfaqësimit politik.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës përfaqëson traditat dhe vlerat historike të qytetarëve turq në Kosovë.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës respekton të drejtat e garantuara me konventa ndërkombëtare dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, angazhohet për avancimin e këtyre të drejtave dhe mbron idenë që tërësia e Kosovës është e padiskutueshme.

Anëtarësimi në Partinë Turke e Drejtësisë së Kosovës është i hapur për të gjithë ata vullnetarë që e përfaqësojnë strukturën politike dhe vlerat e saj.

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës është parti politike që do të angazhohet për sigurimin e kontributit në ndërtimin dhe në forcimin e sundimit të ligjit në institucionet shtetërore, duke u frymëzuar nga proceset dhe nga zhvillimet arsimore, kulturore dhe nga mbrojtja e identitetit, nga të drejtat universale dhe vlerat e lirisë.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës vepron në bazë të parimeve politike të demokracisë; në cilësinë e një partie politike të Kosovës, punon për mbrojtjen dhe për zhvillimin e vlerave kombëtare, familjare dhe individuale; angazhohet për tolerancë dhe liri fetare dhe për krijimin e një shteti të drejtë.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës bazohet në të drejtat themelore të njeriut dhe në vlerat universale. Fuqishëm kundërshton ideologjitë fundamentaliste, totalitare, diskriminuese dhe dukuritë negative sociale.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , me qëllim të realizimit të objektivave të saj, bashkëpunon me EULEX-in, me KFOR-in, me mekanizmat e tjerë vendës e

ndërkombëtarë, me organizata profesionale dhe humanitare, me parti politike, me organizata vendëse e ndërkombëtare.

Kjo parti politike do të punojë që të jetë urë lidhëse në përforcimin dhe shpëstëtimin e raporteve me institucionet shtetërore me Qeverinë e Republikës së Turqisë. Gjithashtu, do të angazhohet dhe do të japë propozime për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, për procesin e integritimeve euroatlantike dhe për integritim në Bashkimin Evropian.

EKONOMIA

Me zbatimin e reformave në periudhën e ardhshme, duhet të përgatitet infrastruktura e duhur, në mënyrë që të sigurohet ndjeshmëria dhe besimi posaçërisht i investitorëve dhe i biznesmenëve të huaj. Edhe Kosova duhet të bëjë plane afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, të përshtatshme me kushtet e rajoneve të saj, ashtu si kanë bërë edhe vendet fqinje.

Me këtë rast, ne, si Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , turqit e Kosovës, biznesmenë dhe investitorë, duhet të luajmë rolin e urës lidhëse ndërmjet Kosovës dhe Turqisë.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të punojë për investime në sektorin e shëndetësisë; për krijimin e mundësive dhe të iniciativave të veçanta, të bazuara në parimet e tregut dhe të konkurrencës së lirë; për krijimin e kushteve të përshtatshme ekonomike dhe ligjore; për lëvizjen e lirë të mallrave, të fuqisë punëtore dhe të kapitalit.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të angazhohet për zhvillimin e politikave fikse alternative, të cilat sigurojnë zhvillimin e prodhuesve vendorë dhe që mundësojnë plasimin e produkteve të tyre në tregjet rajonale.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të interesohet për krijimin e kushteve të volitshme për investitorët e huaj, ngase këto investime mundësojnë krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të angazhohet për zhvillimin e kornizës ligjore për regjistrimin dhe për funksionimin e bizneseve, me qëllim të

sigurimit të kushteve të volitshme, me qëllim të inkurajimit të investitorëve të huaj.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , duke u bazuar në fuqinë e kapitalit, do të punojë për krijimin e sistemit të ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha; me qëllim të krijimit të kushteve të volitshme për zhvillimin e sektorit të prodhimit, në kuadër të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shteteve tjera pse jo edhe Turqisë.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , përkrah tregtinë. Kompanitë turke, me numër të konsiderueshëm, janë të përfaqësuara në Kosovë. Do të kërkojmë mbështetjen e Odës Ekonomike Turke dhe Türk-İş, me qëllim të përfaqësimit të interesave ekonomike të kompanive të fuqishme turke në Kosovë.

POLITIKA SOCIALE DHE SHËNDETËSIA

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës synon zhvillimin e politikave primare, sekondare dhe terciare në shëndetësi, si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale në shëndetësi.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të punojë për krijimin e kushteve të volitshme për ndërtimin e klinikave dhe të qendrave spitalore, për pranimin e specialistëve të fushave të avancuara.

GJUHA TURKE

Sipas nenit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjuhë zyrtare në Kosovë janë: gjuha shqipe dhe gjuha serbe.

Në komunën e Mamushës dhe në komunën e Prizrenit, gjuha turke ka status të gjuhës zyrtare, kurse në komunat e tjera nuk e ka statusin e gjuhës zyrtare.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës , në bashkëpunim me organizatat civile, do të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe do të angazhohet që gjuha turke të përfaqësohet si gjuhë zyrtare në nivel lokal dhe qendror.

Në kohën kur gjuha turke garon me gjuhët e botës, do të bëhen studime në terren për arsyet e zvogëlimit të numrit të folësve të turqishtes në Kosovë dhe do të bëhen aktivitete të duhura përkitazi me këtë çështje. Në këtë mënyrë, do të rritet numri i turqishtfolësve dhe përdorimi i turqishtes do të arrijë nivelin e merituar.

ARSIMI

Po qe se pranohet se ekzistimi i komunitetit turk në Kosovë varet nga arsimi në gjuhën turke dhe nga gjuha turke, angazhimi ynë do të përqendrohet në eliminimin e shkaseve që i dëmtojnë këta dy faktorë të rëndësishëm. Gjatë sistemimit të kuadrove arsimore, prej nivelit të arsimit fillor e deri në atë universitar, në vend të kriterëve politike, do të merren për bazë kriteret pedagogjike dhe përzgjedhja e kandidatëve profesionistë të lëmenjve relevantë. Do të themelohen komisione arsimore për këtë çështje. Disa tekste të botuara shkollore, për nga aspekti i cilësisë dhe për nga aspekti metodologjik, nuk janë të mjaftueshme, prandaj problemi i teksteve shkollore duhet të shqyrtohet nga profesionistët e kësaj fushe. Për këtë do të ndërtohet një bazë e mjaftueshme, në mënyrë që kjo çështje të zgjidhet në kohë të shkurtër. Po qe se paraqitet nevoja, për këtë çështje do të bashkëpunohet me MASHT-in dhe me Ministrinë e Arsimit të Turqisë. Është duke u angazhuar me botime në gjuhën turke. Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës për Drejtësi do të mundohet që interesimin e saj për arsimimin e nxënësve turq, shqiptar, boshnak edhe komuniteteve tjera në të gjitha nivelet, duke u nisur nga arsimi fillor e deri në arsimin universitar, e me këtë rast për krijimin e lehtësive për studime në universitetet publike të Turqisë.

KULTURA

Kultura turke në Kosovë ka një traditë shekullore të pandërprerë. Përkundër mundësive të kufizuara, një numër i madh i organizatave dhe i shoqërive kanë dhënë kontributin e tyre për mbrojtjen dhe për jetësimin e kulturës turke. Për këto organizata dhe shoqata, të cilat me vite janë angazhuar për kulturën dhe për traditën turke, duhet të hapen të gjitha dyert, në mënyrë që t'u ofrohet

mbështetja e nevojshme, dhe duhet të bashkëpunohet me to. Në bashkëpunim me këto organizata, do të organizohen programe dhe simpoziume profesionale, me qëllim të promovimit të kulturës dhe të identitetit turk.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtë me akademikë të ndryshëm në mënyrë që të formohen kadro të nevojshme nga fushat e caktuara të arteve të bukura.

MEDIET

Mediet turke në Kosovë nuk kanë cilësinë e duhur. Do të punohet që këto çështje të zgjidhen, ashtu që, për informim të komunitetit, të tejkalohej vështirësitë e kuadrove dhe vështirësitë materiale.

Do të angazhohemi për mbështetjen e mjediseve të lira e të pavarura mediale, të cilat bëhen zë i organizatave të komunitetit tonë. Do të ofrohet mundësia e komunikimit të shëndoshë, e shprehjes dhe e mendimit të lirë dhe e kritikave me qëllim të mirë. Do të dëshmojmë se personat nuk janë të përhershëm, por se shoqëria është e përhershme. Me një shtyp të lirë dhe të pavarur, do të freskohet ndjenja e lirisë dhe e guximit në komunitet. Nuk do të merren vendime që caktojnë fatin e komunitetit, të bazuara me deklarata të shkurtra dhe të mangëta partiake, por, nëse është e nevojshme, do të organizohen tryeza të rrumbullakëta, ku do të bëhen diskutime të thella për marrjen e vendimeve të duhura. Kur kërkojmë të kemi gazetë, radio a televizion, do ta mbështesim atë, në mënyrë që të jetë media e lirë, pa censurë, dhe e cila i respekton të gjithë dhe të gjitha idetë.

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të angazhohet për hapjen e gazetave e të revistave në gjuhën turke dhe për themelimin e radio-televizioneve të pavarura për shprehje të lirë.

PËRFUNDIM

Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do t'i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për kërkimin e zgjidhjeve të shpejta për problemet e gjuhës turke; për zgjedhjen e problemeve të arsimit në gjuhën turke; për zhvillimin e ekonomisë; për zhvillimin e politikave sociale dhe shëndetësore; për avancimin e kulturës turke dhe për jetësimin e organeve të pavarura mediale.

Turqit që jetojnë në Kosovë, me shekuj kanë kontribuar për zhvillimin e Kosovës, prandaj Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës do të veprojë me ndjeshmëri dhe përgjegjësi në drejtim të realizimit të vullnetit të komunitetit turk. Synimi ynë është të kontribuojmë në formimin e një Kosove shumetnike dhe shumëfetare, duke ruajtur identitetin dhe duke zhvilluar kulturën tradicionale të komunitetit turk.

Ne synojmë t'i realizojmë qëllimet e lartpërmendura, duke siguruar mbështetjen e shumicës, nëpërmjet bashkëjetesës me të gjithë ata që jetojnë në Kosovë.

Deklarohemi se do të punojmë për të dhënë kontributin tonë me të gjitha komunitetet e tjera për integrimin e Kosovës në familjen e madhe evropiane, por duke punuar në mbrojtjen e të gjitha komuniteteve në Kosovë e po ashtu edhe të atij turk sikurse është paraparë me Deklaratën për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Evropë.